

Gjendja e kërkimeve në organizatat think tank në Kosovë

Tryezë: Qershor 2013

Ky raport bazohet në tryezën me temën *Gjendja e Kërkimeve në Organizatat Think Tank në Kosovë* mbajtur më 25 qershor 2013 në Departamentin e Shkencës Politike, Universiteti i Prishtinës (UP). Tryeza u organizua nga Qendra për Kurajo Politike (CPC) me mbështetje të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), nëpërmjet Programit për Promovimin e Hulumtimeve Rajonale në Ballkanin Perëndimor (RRPP). Tryeza adresoi sfidat dhe problemet e tanishme në sektorin e kërkimeve të think tank-ëve në Kosovë. Së pari, ajo kishte për qëllim që të adresoj gjendjen e kërkimeve në organizatat think tank në Kosovë, përfshirë politikat e tyre, metodologjinë kërkimore dhe relevancën e atyre kërkimeve. Së dyti, tryeza synonte që të analizonte politikat e ndjekura nga donatorët më të mëdhenjë në Kosovë dhe se si këto politika adresojnë nevojat e hulumtuesëve aktiv në sektorin think tank. Së fundi, ajo kishte për qëllim që të kontribuonte në ndërtimin e marrëdhënieve më miqësore dhe rrjetëzimin në mes të organizatave think tank dhe donatorëve.

Në tryezë morrën pjesë përfaqësues të disa prej donatorëve më të rëndësishëm në Kosovë, përfshirë znj. Sophie Beaumont, nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe z. Christian Geosits, nga Agjencia Zhvillimore Austriake (ADA). Poashtu, morrën pjesë edhe përfaqësues të organizatave më aktive think tank në Kosovë, si z. Fisnik Korenica dhe z. Dren Doli nga Instituti për Studime Juridike dhe Politike, z. Albert Krasniqi nga Insituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), z. Selatin Kllokoqi nga Demokracia për Zhvillim (D4D) dhe z. Kushtrim Bajrami nga Qendra Kosovare për Arsim (KEC).

Fjala hyrëse

Z. Adem Beha dhe prof. Arben Hajrullahu, në emër të Departamentit të Shkencës Politike dhe CPC, përmbledhën qëllimet e tryezës dhe theksuan nevojën e vendosjes së urave të bashkëpunimit mes organizatave think tank në Kosovë dhe hisedarëve tjerë, përfshirë UP-në dhe donatorët aktiv në Kosovë. Më 5 tetor 2012, CPC në bashkëpunim me SDC dhe RRPP, organizuan konferencën mbi *Rolin e shkencave shoqërore në shoqëritë në tranzicion, me theks të veçantë në Kosovë*. Si rezultat i kësaj konference, CPC kishte dalë me një analizë me titull *Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë*. Kjo analizë kishte zhvilluar rekomandime specifike dhe analizonte gjendjen e kërkimeve në UP, bartësve privat të arsimit të lartë dhe organizatat think tank në Kosovë. Për të avancuar më tutje këtë diskutim, CPC organizoi tre tryeza të tjera duke hulumtuar më imtësisht secilin prej sektorëve të analizuar në analizën *Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë*.

Prof. Arben Hajrullahu vazhdoi fjalimin e tij në mbështetje të rekomandimeve të bëra për organizatat think tank në Kosovë, duke argumentuar se pa investime të mirëfillta në kërkime shkencore, inovacion dhe teknologji nuk mund të arrihet zhvillimi i qëndrueshëm në Kosovë. Së këndejmi, sipas perspektivës së tij mbi donatorët, ai tha se është shumë esenciale se cilat think tank-e përzgjedhen për t'u mbështetur dhe cilat tema duhet të përkrahen. Në lidhje me mbështetjen e institucioneve të Kosovë për shkencë dhe kërkime, prof. Hajrullahu theksoi mungesën e përkushtimit të autoriteteve kosovare për të ndarë fonde të mjaftueshme për të implementuar ligjet dhe strategjitë e tyre që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me shkencën, kërkimet, inovacionet dhe teknologjinë.

Pikëpamjet e donatorëve

Bashkësia e donatorëve ndërkombëtarë kanë kontribuar jashtëzakonisht shumë në etablimin e një shoqërie civile energjike në Kosovë. Megjithatë, me kalimin e fazës së tranzicionit, përkushtimi i bashkësisë së donatorëve kundrejt shoqërisë civile në Kosovë ka rënë ndjeshëm.

Think tank-et në Kosovë, si qendra të orientuar nga zhvillimi i politikave dhe të angazhuara në avokim dhe kërkim, ballafaqohen me disa probleme. Ato kanë mungesë të fondeve dhe kapacitete të pamjaftueshme për të thithur fonde. Think tank-eve ju mungon poashtu ndikimi mbi formimin e politikave, vendosjes së axhendës apo ndryshimin e proceseve vendimmarrëse në Kosovë. Shënimet e përmbledhura nga përfaqësuesit nga ADA dhe Zyra Ndërlidhëse e Bashkimit Evropian në Kosovë janë paraqitur më poshtë.

Z. Christian Geosits nga ADA theksoi angazhimin aktiv të organizatës së tij në sektorin publik të arsimit të lartë në Kosovë. Për shembull, ADA ka ndihmuar në draftimin e ligjit për kërkime, duke luajtur një rol konsultativ. Megjithatë, rekomandimet e bëra nga ekspertët e ADA-së ishin marrë vetëm pjesërisht në konsideratë.

Ka një debat të vazhdueshëm për Fondin për Kërkime Kombëtare, i cili fond momentalisht është vendosur në një rrugë qorre. Fondi kërkon që 0.7% e buxhetit vjetor në Kosovë të dedikohet për një fond kërkimi me ligjin e ri për shkencë, por ky fond nuk ekziston realisht.

Z. Geosits vazhdoi të shpjegojë se ADA provon që investimet e saj t'i drejton kryesisht në UP nëpërmjet partneriteteve dhe programeve kërkimore. Këto programe janë programe të vogla dhe kanë për qëllim të lidhin UP-në me universitetet në Austri. Paralelisht kësaj, ADA mbështet programet shkëmbyese për kandidatë potencial kosovarë për doktoratë apo post-doktoratë në universitetet austriake. Promovimi i kërkimeve në këto programe përfaqëson afër 20% të totalit të programit. Përfituesit janë kryesisht staf i universiteteve publike, por jo individët apo kolegjet private.

Sipas z. Geosits, brenga kryesore e ADA-së ka të bëjë me tregun e kërkimeve në Kosovë dhe rregullimin e këtij sektori. Ai tha se nuk është i sigurt nëse programet e ADA-së adresojnë nevojat e hulumtuesëve në Kosovë, për shkak se organizata e tij ndjek kryesisht udhëzimet e *Strategjisë Kombëtare të Kërkimit në Kosovë*, e cila ka të bëjë me politikat publike që rregullojnë këtë sektor.

Znj. Sophie Beaumont nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë filloi prezentimin e saj duke i informuar pjesëmarrësit rreth ndikimit të think tank-eve në BE dhe Uashington mbi proceset vendimmarrëse dhe se si autoriteti i tyre mund të konsiderohet kontraverzë. Ky perceptim kontraverzë për think tank-et momentalisht nuk ekziston në Kosovë, por perceptimi për think tank në Kosovë mund të ndryshoj me përparimin, zhvillimin dhe maturimin e think tank-eve në Kosovë dhe fuqizimin e ndikimit të tyre në proceset politike dhe të politikbërjes.

Znj. Beaumont solli në tryezë një definicion të think tank-eve. Duke ju referuar këtij koncepti në literaturën shkencore, znj. Beaumont tha se think tank-et nga disa kuptohen si një "universitet jo mësimdhënës", disa të tjerë e definojnë atë si një "grup lobimi". Kështu që, një think tank duhet të japë këshilla dhe ekspertizë në zhvillimin e politikave, ashtu siç mund të demonstron sot në BE, ku kjo e fundit vendos kontakte të afërta me think tank-e dhe universitete gjatë zhvillimit të politikave të saj.

Znj. Beaumont gjithashtu diskutoi mundësitë e mëdha për t'u qasur në fonde për organizatat think tank. Programi për kërkime, i ashtuquajtur "Horizon 2020" do të ndajë €8 miliardë për qëllime kërkimore. Edhe pse ka mundësi financimi në Kosovë, sfida kryesore mbeten kapacitetet e organizatave think tank për të konkuruar në të ardhmen në nivel rajonal dhe atë evropian. Për aq sa Kosova do t'i përafrohet anëtarësisht në BE, think tank-et kërkimore në Kosovë duhet të bëhen gati për t'i rritur aftësitë konkurruese të tyre. Në këtë aspekt, znj. Beaumont rekomandoi që think tank-et të fokusohen në ndërtimin e kapaciteteve për të shkruar projekte hulumtuese dhe që të fuqizojnë bashkëpunimin me universitetet.

Çfarë është think tank-u?

Ka mospajtime akademike mbi definicionin dhe shpjegimin e asaj që përbën një think tank. Andrew Rich, profesor asistent i shkencës politike në City College of New York, definon think tank-et si “organizata të pavarura, të bazuara jo në interesa dhe joprofitabile që prodhojnë dhe parimisht mbështeten mbi ekspertizën dhe idetë për të marrë mbështetje dhe për të influencuar proceset politikbërëse”.¹ Në njëërën anë, duke i shikuar në aspektin operacional, sipas Rich, think tank-et janë organizata jo profitabile që kanë për qëllim shpërndarjen e kërkimeve potenciale mbi çështje publike. Në anën tjetër, duke i shikuar në aspektin politik, think tank-et kanë për qëllim të influencojnë politikbërjen. Në këtë aspekt, besueshmëria dhe relevanca e kërkimeve janë dy prej faktorëve më të rëndësishëm të think tank-eve.

James G. McGann, profesor në Universitetin e Pensilvanisë jep një definicion më të gjerë: “Think tank-et, ose institucionet e kërkimeve të politikave publike, analizës dhe angazhimit janë organizata që gjenerojnë kërkime të orientuara nga ndryshimi i politikave, analiza, dhe këshilla mbi çështjet vendore dhe ndërkombëtare në përpjekje për t’i mundësuar politikbërësve dhe publikut marrjen e vendimeve të bazuara në informata rreth çështjeve politike publike”.² Në analizën e tij të think tank-eve në SHBA, McGann argumenton se ekzistojnë tre forma të mundshme të organizimit:

1. “Think tank-et tradicionale”, që i koncentrojnë burimet e tyre ekskluzivisht në hulumtime shkencore të politikave (p.sh. Hoover Institution dhe Woodrow Wilson International Center for Scholars);
2. “Think-and-do tank” (organizata jo vetëm kërimore, por edhe vepruese), të cilat kryejnë hulumtime, analiza të politikave dhe kampanja publike (p.sh. Brookings Institution, Carnegie Endowment for International Peace, Economic Policy Institute, American Enterprise Institute and Heritage Foundation);
3. “Do tank” (organizata vepruese), të cilat fokusojnë gjithë energjinë në ripaketimin dhe përhapjen e ideve dhe propozimeve të think tank-eve tjera (p.sh. Demos, Capital Research Center and Free Congress Foundation).³

Think tank-et kosovare

Sipas raportit të vitit 2013 të Freedom House për Kosovën, rangimi i shoqërisë civile ka pësuar rënie nga 3.75 në 4, krahasuar me gjendjen e shoqërisë civile në Kosovë të një viti më parë.⁴ Organizatat jo-qeveritare, përfshirë think tank-et në Kosovë, janë të rregulluara me *Ligjin mbi Lirinë e Asocimit të OJQ-ve*.⁵ Prej më shumë se 6000 OJQ-ve të regjistruara në Kosovë, vetëm 8 prej tyre janë think tank që merren me kërkime. Sipas Agjencisë së Statistikave në Kosovë, prej 208,454 të punësuarëve në Kosovë, vetëm 141 prej tyre punojnë në sektorin e kërkimeve (0.5% e totalit të punësuarëve).⁶ Gjendja e organizatave think tank në Kosovë nuk është më premtuesja. Organizatat think tank në Kosovë ende nuk kanë krijuar

mekanizma të brendshëm të kontrollit dhe të sigurimit të cilësisë. Shumica e kërkimeve të tyre bazohet në metodologjinë kualitative dhe jo atë kuantitative dhe këto organizata nuk kanë staf të mjaftueshëm për të konkurruar me kërkimet e tyre, qoftë në nivel rajonal apo ndërkombëtar. Tani është pothuajse e domosdoshme që si organizatat think tank, ashtu edhe institucionet publike të ndërtojnë relacione të besueshme me njëra tjetrën në mënyrë që të ketë përparime efektive në kohë optimale. Paragrafët e mëposhtëm përmbledhin sfidat dhe bregat me të cilat ballafaqohen organizatat think tank në Kosovë.

Z. Fisnik Korenica nga Instituti për Studime Juridike dhe Politike vlerësoi rëndësinë e organizimit të tryezës mbi gjendjen e kërkimeve në Kosovë duke kritikuar faktin që, siç tha ai, kërkimet dhe zhvillimi janë gjërat e fundit për të cilat politikbërësit bregosen në Kosovë. Z. Korenica vlerëson se është nevojë imediate që të krijohen mekanizma të pavarur për të kontrolluar mënyrën se si dedikohen dhe shpenzohen mjetet në kërkime. Ai e quajti tregun e kërkimeve në Kosovë “një treg qesharak”, për shkak të faktit se mbi 90% të kërkimeve të bëra në Kosovë janë spekulative dhe kryesisht të koncentruara në libra shkollor. Duke marrë për bazë këtë, z. Korenica tha se në Kosovë ka hulumtues që kanë të botuar trembëdhjetë libra shkollor, por librat shkollor janë libra të dijes së përgjithshme dhe nuk janë të lidhur me kërkimet në nivel global. Për më tepër, sipas tij, këto libra shkollor konsiderohen si libra me kualitet të “dobët” për shkak se në këto libra është e vështirë të gjenden dhjetë citime në afërsisht treqind faqe tekst libri. Z. Korenica tha se shumica e të ashtuquajturit “kërkim” në Kosovë nuk ka qenë kurrë e rishikuar as brenda vendit as në aspektin ndërkombëtar dhe se i njëjti kërkim nuk kalon kurrë nëpër asnjë procedurë të lekturimit të gjuhës, rishikimit të hipotezave dhe përmbushjes së standardeve ndërkombëtare të publikimit. Z. Korenica risolli kohën e Jugosllavisë ku regjimi jugosllav maste kërkimet në mënyrë kuantitative dhe jo kualitative. Fatkeqësisht, sipas tij i njëjti problem është duke u shfaqur pjesërisht edhe brenda UP-së për shkak se në asnjë prej revistave të vendit nuk kontrollohet studimi akademik dhe cilësia e publikimit është shumë e dobët.

Përkritazi me tryezën, z. Korenica nënvizoi zbrastirën dhe diferencën e madhe mes universiteteve dhe think tank-eve. Sipas tij, think tank-et janë qartësisht qendra të orientuara nga politikat, p.sh., Instituti për Studime Juridike dhe Politike nuk bën kërkime shkencore, siç mund të bënin universitetet kërkime shkencore, duke pasur parasysh kërshërinë akademike. Ai tha se instituti i tij bën kërkime që kanë të bëjnë me zgjidhjen praktike të problemeve të prekshme. Ndaras kësaj, z. Korenica tha se është tepër e vështirë të shohësh institucionet lokale duke ju referuar kërkimeve që bëhen nga organizatat think tank në Kosovë. Si rrjedhojë, shumica e vendimeve në Kosovë nuk

1 Andre Rich. *Think Tanks, Public Policy and Politics of Expertise*. Cambridge University Press, 2004. f. 11-12.

2 James G. McGann. *Think Tanks and the Policy Advice in the United States* Routledge, 2007. f. 12.

3 ibid.

4 http://www.freedomhouse.org/sites/default/files/NIT13_Kosovo_2ndProof.pdf (qasur më 29 qershor 2013)

5 Ligj Nr. 03/L-134 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-134_al.pdf (qasur më 31 korrik 2013)

6 Kosovo Agency of Statistics. *Kosovo Population and Housing Census 2011: Main Data 2012*.

bazohen në informata të sakta para se ato vendime të merren. Sidoqoftë, sa i përket aspektit cilësor të kërkimeve, organizatat think tank në Kosovë qëndrojnë mirë në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Ai mori shembullin e organizatave think tank në Shqipëri ku shumica e këtyre organizatave janë të politizuara dhe për pasojë prodhojnë më shumë deklarata politike spekulative duke mbështetur apo shpifur për parti politike të caktuara. Sipas z. Korenica, tregu i organizatave think tank në Kosovë është më i miri në rajon përkundër faktit se numri i këtyre organizatave është i vogël, dhe kjo falë investimeve enorme të donatorëve në katërmbëdhjetë vitet e fundit në Kosovë. Për dallim prej organizatave të tjera të shoqërisë civile, organizatat think tank nuk bëjnë kërkime vetëm për të përmbushur kërshërinë e publikut të gjerë, por për të influencuar politikbërjen. Z. Korenica gjithashtu theksoi nevojën e fuqizimit të kapaciteteve avokuese të organizatave think tank dhe kualitetin e studimeve të publikuara.

Sipas z. Korenica, janë tre probleme me të cilat ballafaqohet sektori i organizatave think tank në Kosovë: 1) Mekanizmat për kontrollin e cilësisë brenda organizatave think tank; 2) Metodologjia dhe nivelet joadekuate të kërkimeve kuantitative; 3) Konkurrenca mes kërkimeve është jo substanciale dhe hulumtuesit në Kosovë duhet të mësojnë të garojnë si në nivelin rajonal ashtu edhe atë ndërkombëtar, për shkak se kjo është kërkesë e tregut.

Z. Albert Krasniqi filloi fjalën e tij duke ju referuar mbështetjes që KIPRED i ka dhënë Kuvendit të Kosovës në themelimin e dy komisioneve parlamentare. Ai diskutoi komplikimet me të cilat është ballafaquar KIPRED gjatë themelimit të këtyre mekanizmave, në veçanti mungesën e besimit të shfaqur nga Kuvendi i Kosovës, i cili stafin e KIPRED-it në Kuvend e quante “spiunë” të donatorëve ndërkombëtarë. Për z. Krasniqi, ndërtimi i besimit mes institucioneve të Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile është i domosdoshëm si për organizatat think tank që të vendosin axhendën e tyre të pavarur të kërkimeve, ashtu edhe për institucionet publike, që vendimet e tyre për politikën publike të bazohen mbi informata të prodhura nga organizatat think tank.

Z. Selatin Klllokoqi nga D4D prezantoi aktivitetet e organizatës së tij në ndërtimin e kapaciteteve kërkimore. D4D në vazhdimësi angazhon hulumtues që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, por njëkohësisht mbështet praktikantë që vijnë nga UP-ja. Momentalisht, D4D është duke ndërtuar një e-librari për të deponuar publikimet kërkimore dhe për t'i bërë ato të qasshme për publikun. Studentët dhe publiku mund të ketë qasje në këtë bazë të dhënash në mënyrë më të lehtë dhe mund t'i përdor këto informata në të ardhmen.

D4D, sikurse është rasti edhe organizatat e tjera think tank, është kritikuar nga institucionet publike. Z. Klllokoqi tha se kritika vjen atëherë kur hulumtimi që është kryer nga një organizatë e tipit

think tank kërkon intervenim të menjëhershëm të institucioneve publike. Ata që do të duhej t'i implementonin rekomandimet e bëra nga organizatat think tank janë pikërisht ata që shumicën e kohës e shpenzojnë duke i kritikuar organizatat think tank në vend që të shfrytëzojnë këto informata dhe ekspertizën e tyre kërkimore në proceset vendimmarrëse. Për më tepër, z. Klllokoqi tha se organizatat think tank në Kosovë nuk marrin mbështetje financiare nga institucionet publike, duke iu referuar fondeve që ndahen për shkencë dhe kërkime nga Ministria për Shkencë dhe Teknologji (MASHT). Fondet e ministrisë dhe ato të donatorëve, sipas tij, nuk duhet të drejtohen vetëm drejt UP-së, por edhe drejt organizatave think tank të cilat kanë treguar se mund të kryejnë kërkimeve të rëndësishme të veçanta. Ai tha se, përkundër faktit të investimeve të mëdha të kanalizuar në UP, asnjë përmirësim nuk është shënuar në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve kërkimore në këtë institucion. Sipas z. Klllokoqi, bashkëpunimi mes UP-së dhe organizatave think tank në Kosovë është i pamjaftueshëm dhe duhet të përmirësohet.

Z. Kushtrim Bajrami nga KEC insistoi në nevojën që organizatat think tank dhe institucionet publike të kenë qasje përfshirëse gjatë punës kërkimore të tyre në Kosovë. Një prej problemeve kyçe, sipas z. Bajrami, është se disa organizata think tank në Kosovë merren kryesisht me shumë probleme njëkohësisht dhe është e nevojshme që këto organizata të interesohen më shumë në politika të veçanta.

Rekomandimet

Donatorët të:

- Dedikojnë më shumë investime për organizatat think tank në Kosovë;
- Fuqizojnë organizatat think tank në Kosovë.

Think Tank-et të:

- Krijojnë mekanizma të kontrollit të cilësisë për të rritur lexueshmërinë, kualitetin dhe relevancën e kërkimeve të tyre;
- Zhvillojnë kapacitete përbrenda për të kryer kërkime masive dhe për t'i rritur kërkimet kuantitative;
- Fuqizojnë kapacitetet avokuese dhe rrisin kualitetin e kërkimeve studimore;
- Fuqizojnë shkathtësitë për të konkurruar me tregun e BE-së;
- Ndërtojnë kapacitete për të shkruar aplikacione që kanë të bëjnë me hulumtime masive;
- Shfrytëzojnë dhe rekrutojnë më shumë staf me doktoratë;
- Rrisin bashkëpunimin me institutet tjera hulumtuese në UP;
- Krijojnë besim me institucionet publike relevante për të deliberuar me hisedarët e tjerë publik, për çështjet dhe politikën publike;
- Fokusohen më shumë në çështje të politikave konkrete dhe jo në shumë probleme njëkohësisht.